



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Seanca nr.2003/36

Prishtinë,më 18 dhjetor 2003,në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Fatmir Sejdiu,anëtar i Kryesisë, kurse bashkëkryesues ishte Hydajet Hyseni,anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 88 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2004 dhe
3. Shqyrtimi i parë i Projektlegjislacionit për bashkëpunimin e Kosovës me Tribunalin Penal të Hagës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Procesverbalit të seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

Sabit Rrustemi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me bastisjen e shtëpisë së tij dhe të lagjës në fshatin Zhegër të Gjilanit nga ana e ushtarëve të KFOR-it. Ai kërkoi që Kuvendi të angazhohet për mbrojtjen e imunitetit të deputetëve.

Ismajl Krteshi, në emër të Grupit parlamentar të PDK-së, propozoi që si çështje e ngutshme të vihet në rend ditë të kësaj seance ose të seancës së ardhshme, organizimi i zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë.

Dragisha Krstoviq i bëri vërejtje kryesuesit të seancës pse nuk ua ndërpreu diskutimin parafolësve.

Kryesuesi tha se Kryesia e Kuvendit do ta marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar.

2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2004

Kryesuesi kërkoi sqarime nga kryetari i Komisionit të Buxhetit lidhur me përgatitjen e raportit me rekomandime për shqyrtimin e dytë të këtij p/ligji.

Haki Shatri, në emër të Komisionit për Buxhet, theksoi se Komisioni për Buxhet dhe të Komisionit për Ekonomi dhe Financa, nuk kanë mund ta përgatisin raportin për këtë seancë për shkak të ndërlikueshmërisë që ka kjo materie dhe dualizmave që janë paraqitur lidhur me të. Ai kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme të 22 dhjetorit 2003.

Arsim Bajrami kërkoi sqarime nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë se a janë të pavarura në përcaktimin e parametrave të buxhetit të Kosovës. Ai kërkoi të rishqyrtohet P/buxheti për vitin 2004 dhe të rritet shuma e mjeteve të parapara për TMK-në dhe për fushën e arsimit.

Kryesuesi e hodhi në votë propozimin e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe rezultati ishte si vijon:

Për ----- shumica;

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi propozimin për shtyrjen e shqyrtimit të dytë të P/buxhetit të Kosovës për vitin 2004 për seancën e ardhshme plenare të 22 dhjetorit 2003.

3. Shqyrtimi parë i Projektlegjislacionit për bashkëpunimin e Kosovës me Tribunalin Penal të Hagës.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës ta arsyetonte para deputetëve këtë p/legjislacion.

Kryeministri Bajram Rexhepi theksoi se Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë iniciativën për përgatitjen e Projektligjit për bashkëpunim të Kosovës me Tribunalin Penal të Hagës për shumë arsye. Jemi nisur nga maksima juridike se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe konform kësaj maksime duhet të sigurohen parakushtet e duhura, që të gjithë qytetarëve të Kosovës t’iu mundsohet të jetojnë të lirë e të sigurtë dhe mbrojtja ligjore në rast të përballjes me akuza para gjyqit. Jemi nxitur për përgatitjen e këtij Projektligji gjithashtu edhe nga nevoja që të pengohen sjelljet dhe veprimet arbitrare të organeve të ndjekjes dhe jo vetëm të tyre. Jemi nxitur gjithashtu edhe nga aktualiteti kosovar i cili mbështetet në faktin se Kosova është e gatshme të ballafaqohet me të gjitha sfidat që paraqiten si pengesë në sigurimin e mirëqenies së njerëzve dhe zbatimin e të gjitha lirive dhe të drejtave të garantuara me aktet juridike relevante si vendore ashtu edhe ndërkombëtare.

Projektligji është i bazuar dhe i harmonizuar edhe me Statutin e Tribunalit të Hagës dhe rregulloret e tjera të procedurës së Tribunalit të Hagës.

Me këtë p/ligj synohet vendosja e bashkëpunimit me Tribunalin e Hagës pa anashkalim të institucioneve vendore dhe me një rol përmbajtësor të tyre.

P/ligji përmban dispozitat për:

- Sigurimin e kushteve teknike dhe lehtësimin e punës së Zyrës së Tribunalit Penal të Hagës, e cila vepron në territorin e Kosovës;
- Transferimin e procedurës penale në Tribunalin Penal të Hagës, ku vepra hyn në kompetencë të Tribunalit Penal të Hagës;
- Ndalimin e gjykimit të serishëm pranë organeve kompetente të Kosovës, atëherë kur kryesi një herë është gjykuar dhe është vendosur rasti nga Tribunali Penal i Hagës;
- Ekzekutimin e kërkesës së Tribunalit Penal të Hagës për dorëzimin e të pandehurit;
- Afrimin e ndihmës juridike Tribunalit Penal të Hagës që do ta bëjnë organet kompetente të Kosovës, duke përfshirë edhe gatishmërinë për lidhjen e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimit të shqiptuar.

P/ligji rregullon çështjet komplekse dhe në veçanti bashkëpunimin reciprok në procesin e ndjekjes dhe shqiptimin e dënimit të kryerësit për vrasje të qëllimta, torturë apo trajtim çnjerëzor, deportim të jashtëligjshëm, marrje peng të civilëve.

Në fund, kryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

Kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij p/ligji, në parim.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, bëri vërejtje terminologjike, se në propozimin e Qeverisë shkruhet Projektlegjislacion, kurse kryeministri gjatë arsyetimit të tij përdori termin Projektligj. Procedura e propozuar për shqyrtimin e këtij p/ligji ndryshon nga procedurat e rregullta të Kuvendit. Thuhet se Kuvendi duhet ta shqyrtojë këtë p/ligj dhe amendamente t’ia dërgojë Qeverisë, kurse Qeveria t’ia dërgojë PSSP-së.

Ai kërkoi që të respektohen procedurat e rregullta të Kuvendit edhe për shqyrtimin e këtij p/ligji. Pati vërejtje edhe në mospërkufizimin e autoritetit përfundimtar për zbatimin e tij.

Arsim Bajrami, në emër të Grupi Parlamentar të PDK-së theksoi se e përkrah në parim këtë p/ligj. Ai kërkoi të bëhen sqarime ndërmjet aktit të propozuar si Projektlegjislacion që nuk dihet se a është rregullore e UNMIK-ut apo ligj i Kuvendit. Propozoi që ky akt të quhet ligj dhe t'i nënshtrohet procedurave të rregullta –shqyrtimi i parë dhe i dytë i tij.

Kosova me këtë ligj po institucionalizon bashkëpunimin e saj me Tribunalin e Hagës që është shumë pozitive, duke pasur parasysh edhe problemet që janë paraqitur më herët, sidomos problemet rreth rastit Limaj, kur një dorëzim apo një paraqitje vullnetare e tij në Tribunalin e Hagës u kualifikua si një arrestim dhe për këtë ka nevojë që të kemi këtë ligj i cili përcakton edhe procedurat se si procedohet me kërkesën e Tribunalit të Hagës.

Çështja e dytë që ka mbetur e pasqaruar në propozimin e këtij Projektligji është çështja e autoritetit kompetent. Kush është partner apo autoritet kompetent që të bashkëpunojë me Tribunalin e Hagës? A është Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm apo është Qeveria e Kosovës?

Meqenëse Qeveria e Kosovës po sponsorizon këtë ligj, Qeveria e Kosovës duhet të jetë autoriteti kompetent.

Lilana Keniq, në emër të Grupit Parlamentar «Kthimi», theksoi se në propozimin e Qeverisë theksohet bashkëpunimi me Tribunalin e Hagës për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Ajo propozoi që ligji të përfshijë personat që kanë bërë krime edhe pas përfundimit të luftës, përkatësisht pas hyrjes së forcave të KFOR-it dhe administratës së UNMIK-ut.

Normimi i kësaj materie është në kompetencë të PSSP-së, shtoi ajo dhe Kuvendi duhet të nxjerrë vetëm rezolutë për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës. Ajo pati vërejtje edhe në përorimin e terminologjisë në këtë p/ligj.

Bujar Dugolli, në emër të Grupit parlamentar të AAK-së, theksoi se Kuvendi më herët e ka miratuar një rezolutë për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës, por është kërkuar që bashkëpunimi të realizohet në bazë të një ligji që do ta miratojë Kuvendi i Kosovës.

Tribunali i Hagës nuk i ka rrespektuar institucionet e Kosovës dhe qytetarët e saj që janë akuzuar nga ai. Ky mosrrespektim ka qenë në mungesë të ligjit të Kosovës për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës.

Vërejtjet tona janë se Qeveria nuk e ka pasur guximin e duhur të hartojë një p/ligj që do t'u jipte institucioneve të Kosovës, Kuvendit dhe Qeverisë rolin që duhet ta kenë për këtë çështje, të paktën ashtu siç e kanë vendet e Ish-Jugosllavisë. Në p/ligj nuk është saktësuar se kush është “autoriteti kompetent” gjë që duhet të saktësohet.

Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah në parim këtë p/ligj, por me amendamente duhet të precizohet roli i Qeverisë së Kosovës dhe roli i mbrojtjes institucionale i të akuzuarve.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë p/ligj i dhanë edhe këta deputetë: Ramadan Kelmendi, Hydajet Hyseni, Smajl Latifi, Mevlyde Saraçi, Hasan Meta, Dragisha Krstoviq, Xhavit Haliti dhe Gani Koci që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesuesi e hodhi në votë propozimin e Qeverisë për miratimin e këtij p/ligji dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----1;
Abstenime----- 11.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për bashkëpunim me Tribunalin Penal të Hagës dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin FunkSIONALT ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

Kryesuesi tha se seanca e ardhshme e Kuvendit do të mbahet më 22 dhjetor 2003.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11:35 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryesuesi i seancës plenare,

Prof.dr.Fatmir SEJDIU